PUBLIC
Date original: 04/12/2025 17:44:00
Date translation: 17/09/2026 13:50:00

KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës:	**KSC-BC-2023-12**
	Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit
Vendosi:	**Gjykatësi i Vetëm**
	Gjykatës Kristofer Gosnell
Administratore:	Fidelma Donlon
Data:	4 dhjetor 2025
Gjuha:	Anglishte
Klasifikimi:	**Publik**

Urdhër për Datën e Fillimit të Gjykimit

Prokurores së Specializuar
Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

PUBLIC
Date original: 04/12/2025 17:44:00
Date translation: 17/09/2026 13:50:00

GJYKATËSI I VETËM, në bazë të neneve 21(4)(d) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (″Ligji″) dhe rregullës 118(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (″Rregullorja″),[1] lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën kundër të akuzuarve,[2] të cilët u arrestuan dhe u ndaluan menjëherë më pas,[3] përveç Hajredin Kuçit, i cili mori fletëthirrjen për paraqitjen e tij të parë.[4]

2. Më 12 nëntor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, në bazë të rregullës 98(1), ia kaloi dosjen e plotë të çështjes Gjykatësit të Vetëm.[5]

3. Më 17 nëntor 2025, Gjykatësi i Vetëm planifikoi konferencën përgatitore për gjykim dhe konferencën përgatitore të Prokurorit të Specializuar në bazë të rregullave 117(1) dhe 118(1) për 28 nëntor 2025, dhe ftoi palët dhe Zyrën Administrative të dorëzonin parashtrime me shkrim lidhur me gatishmërinë dhe përgatitjen për gjykim, si dhe për zhvillimin e procesit.[6]

---

[1] Të gjitha referencat ndaj "neni" dhe "rregulla" duhet të kuptohen se u referohen neneve dhe rregullave përkatësisht të Ligjit dhe Rregullores, përveç nëse saktësohet ndryshe

[2] F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 12 shkurt 2025, F00036/RED.

[3] KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse* ("Vendimi mbi Fletarrestimet dhe Fletëthirrjet"), 29 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik u lëshua më 19 dhjetor 2024, F00037/RED.

[4] Decision on Arrest and Summons (Vendimi mbi Fletarrestimet dhe Fletëthirrjet) para. 100.

[5] KSC-BC-2023-12, F00544, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Decision Transmitting the Case File to Single Trial Judge*, (Vendim mbi Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Gjykatësit të Vetëm), 12 nëntor 2025, publik.

[6] KSC-BC-2023-12, F00549, Gjykatësi i Vetëm, *Order Scheduling the Trial Preparation Conference and Requesting Submissions* (Urdhër për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencës Përgatitore për Gjykim dhe për Kërkim të Parashtrimeve) ("Urdhri"), 17 nëntor 2025, publik.

PUBLIC
Date original: 04/12/2025 17:44:00
Date translation: 17/09/2026 13:50:00

4. Më 20 dhe 24 nëntor 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), Zyra Administrative dhe secili prej ekipeve të Mbrojtjes dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim në përputhje me Urdhrin e Gjykatësit të Vetëm.[7]

5. Më 28 nëntor 2025, Gjykatësi i Vetëm mbajti konferencën përgatitore për gjykim dhe konferencën përgatitore të Prokurorit të Specializuar, gjatë së cilës u bënë parashtrime gojore shtesë për aspekte të lidhura me planifikimin e gjykimit.

6. Më 2 dhjetor 2025, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi palët të siguronin disponueshmërinë e tyre gjatë periudhës nga 26 janari 2026 deri më 6 shkurt 2026.[8]

II. PARASHTRIMET

A. PARASHTRIMET E ZPS-SË

7. Nga 20 nëntori 2025 deri më 2 dhjetori 2025, ZPS-ja bëri parashtrime të ndryshme në lidhje me datën e fillimit të gjykimit: fillimisht duke propozuar

[7] *Shih* F00558, Administratorja, *Parashtrime të Administratores për Konferencat Përgatitore për Gjykim*, 20 nëntor 2025, publike, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00559, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë sipas Parashtrimit F00549*, ("Parashtrimet e ZPS-së"), 20 nëntor 2025, konfidenciale; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 26 nëntor 2025, F00559/RED; F00565, Mbrojtja e Bashkim Smakajt ("Mbrojtja e Smakajt"), *Parashtrime të Mbrojtjes së Smakajt për Konferencën Përgatitore për Gjykim* ("Parashtrimet e *Smakajt*"), 24 nëntor 2025, konfidenciale; F00567, Mbrojtja e Hajredin Kuçit ("Mbrojtja e Kuçit"), *Parashtrime të Mbrojtjes së Kuçit për Konferencën Përgatitore për Gjykim* ("Parashtrimet e *Kuçit*"), 24 nëntor 2025, konfidenciale; F00568, Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit"), *Parashtrime të Mbrojtjes së Thaçit për Konferencën Përgatitore për Gjykim* ("Parashtrimet e *Thaçit*"), 24 nëntor 2025, konfidenciale; F00569, Mbrojtja e Isni Kilajt ("Mbrojtja e Kilajt"), *Parashtrime të Mbrojtjes së Kilajt për Konferencën Përgatitore për Gjykim* ("Parashtrimet e *Kilajt*"), 24 nëntor 2025, konfidenciale; F00570, Mbrojtja e Fadil Fazliut ("Mbrojtja e Fazliut"), *Parashtrime të Mbrojtjes së Fazliut për Konferencën Përgatitore për Gjykim* ("Parashtrimet e *Fazliut*"), 24 nëntor 2025, publike.

[8] KSC-BC-2023-12, CRSPD171, *Korrespondencë drejtuar palëve lidhur me disponueshmërinë e tyre*, 2 dhjetor 2025, ora 15:01, konfidenciale.

fillimin e shkurtit 2026,[9] më pas "mesin ose fundin e shkurtit" 2026[10] dhe, së fundmi, "23 shkurtin ose 2 marsin" 2026.[11]

8. ZPS-ja parashtron se gjykimi duhet të zhvillohet brenda "një blloku kohor të veçantë pa vonesë."[12] Ajo parashikon që kohëzgjatja e gjykimit të jetë "jo më shumë se dy javë",[13] dhe se të tre dëshmitarët e saj mund të dëgjohen brenda një jave.[14] Ajo parashtron se data e fillimit të gjykimit varet nga përfundimi i hapave hetimorë nga ofruesit e shërbimeve të jashtme dhe shqyrtimi dhe nxjerrja pasuese e dokumenteve nga ZPS-ja, të cilat janë të domosdoshme para fillimit të gjykimit.[15] ZPS-ja parashtron se hapat hetimorë të papërfunduar janë të rëndësishëm dhe të kufizuar, dhe se çdo vonesë në përfundimin e këtyre hapave i atribuohet faktorëve jashtë kontrollit të saj.[16]

9. ZPS-ja gjithashtu parashtron se do të jetë në gjendje të dorëzojë mocionin e saj për pranimin e provave që nuk janë pjesë e dëshmive, dhe çdo mocion sipas rregullës 154, deri në javën e 15 dhjetorit 2025.[17]

10. Së fundi, ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Vetëm të rishqyrtojë vendimin e tij për të zhvilluar Konferencën Përgatitore për Gjykimin dhe Konferencën Përgatitore të Prokurorit të Specializuar gjatë së njëjtës seance, dhe të caktojë një Konferencë Përgatitore të veçantë të Prokurorit të Specializuar në mes të janarit.[18]

---

[9] Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.
[10] KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës, *Konferenca Përgatitore për Gjykim* ("Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin"), 28 nëntor 2025, f. 223, rreshtat 5-11.
[11] KSC-BC-2023-12, CRSPD171, *Korrespondencë drejtuar palëve lidhur me disponueshmërinë e tyre*, 2 dhjetor 2025, ora 18:40, konfidenciale.
[12] Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.
[13] Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.
[14] Parashtrimet e ZPS-së, poshtëshënimi 3.
[15] Parashtrimet e ZPS-së, para. 3, 6.
[16] Parashtrimet e ZPS-së, para. 7-21; Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 221, rreshtat 24-25, f. 222, rreshtat 1-2, f. 224-232.
[17] Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.
[18] Parashtrimet e ZPS-së, para. 35.

B. PARASHTRIMET E MBROJTJES

1. Mbrojtja e Thaçit

11. Mbrojtja e Thaçit parashtron se nuk është e disponueshme nga 26 janari deri më 6 shkurt 2026 dhe se nuk do të jetë gati për fillimin e gjykimit "para fillimit të marsit 2026" për shkak të kërkesave konkurruese të imponuara nga afatet e përcaktuara nga Trupi Gjykues II në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve*. ("Çështja 06"),[19] të cilat përfshijnë afatin e 19 janarit 2026 për dorëzimin e dosjeve gjyqësore përfundimtare dhe argumentet përmbyllëse të planifikuara për 9-13, 16 dhe 18 shkurt 2026.[20]

12. Mbrojtja e Thaçit nuk e kundërshton propozimin e ZPS-së për të paraqitur mocionin e saj për "provat jogojore" gjatë javës së 15 dhjetorit 2025. Megjithatë, ajo kërkon që afati të përshtatet/ndryshohet "për të siguruar që Mbrojtja të ketë kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur, duke përfshirë pezullimin e afateve për përgjigje dhe kundërpërgjigje gjatë pushimit të gjykatës."[21] Mbrojtja e Thaçit parashtron se në qoftë se ZPS-ja do të dorëzonte mocionin e saj për provat jogojore deri më 15 dhjetor 2025, ajo do të ishte në gjendje të përgjigjej deri në javën e 5 janarit 2026 dhe do të bënte çdo kërkesë për zgjatje afati për t'u përgjigjur, nëse është e nevojshme, pas dorëzimit së mocionit të "provave jogojore" të ZPS-së.[22]

13. Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit argumenton se ZPS-ja "nuk ka të drejtë të pakufizuar për të kryer hetime në fazën e gjykimit",[23] dhe se çdo mocion për të

[19] Parashtrimet e *Thaçit*, para. 9-16. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-12, CRSPD171, *Korrespondencë drejtuar palëve lidhur me disponueshmërinë e tyre,* 2 dhjetor 2025, ora 15:50, konfidenciale.
[20] KSC-BC-2020-06, F03597, Trupi Gjykues II, *Order Pursuant to Rules 134(b), (d) and 159(6) and Related Matters*, (Urdhër sipas Rregullave 134(b), (d) dhe 159(6) dhe Çështje të Lidhura me Të), 21 nëntor 2025, publik, para. 39(f)-(g); Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 245, rreshtat 23-25, f. 246, rreshti 1.
[21] Parashtrimet e *Thaçit*, para. 22.
[22] Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 207, rreshtat 2-8.
[23] Parashtrimet e *Thaçit*, para. 17.

paraqitur prova që rrjedh nga këto hetime duhet të paraqitet para fillimit të gjykimit për të shmangur dëmtimin e z. Thaçi.[24]

2. Mbrojtja e Smakajt

14. Mbrojtja e Smakajt parashtron se të dy mbrojtësit janë të disponueshëm për gjykim në periudhën nga 19 janari deri më 13 shkurt 2026, dhe përsëri nga 2 deri më 27 mars 2026. Ajo parashtron se asnjëri nga mbrojtësit nuk është i disponueshëm nga 27 marsi deri në qershor 2026.[25] Mbrojtja e Smakajt kërkon që "gjykimi të planifikohet gjatë periudhave të lartpërmendura, përkatësisht në janar, shkurt dhe mars."[26] Ajo argumenton se mocioni i provave jogojore i ZPS-së duhet të ishte dorëzuar tashmë,[27] dhe se hetimet e ZPS-së nuk mund të vazhdojnë pafundësisht.[28]

3. Mbrojtja e Kilajt

15. Mbrojtja e Kilajt parashtron se ajo "do të ishte gati të fillonte në janar 2026", por se "nuk do të kishte ndonjë kundërshtim konkret lidhur me një datë më të vonë fillimi, siç mund të ishte e nevojshme për t'ju përshtatur interesave të të bashkakuzuarve [z. Kilaj]."[29] Ajo parashtron se koha për hetimet e ZPS-së "nuk duhet të jetë e pafundme" dhe se Gjykatësi i Vetëm "duhet t'i japë fund" hetimeve të tilla.[30]

4. Mbrojtja e Fazliut

16. Mbrojtja e Fazliut gjithashtu parashtron se hetimet e ZPS-së nuk duhet të jenë të pafundme, dhe ia lë në dorë Gjykatës të caktojë datën për fillimin e gjykimit.[31] Ajo vëren se periudhat e paraburgimit në pritje të gjykimit nuk mund

[24] Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 234, rreshtat 16-25, f. 235, rreshtat 1-7.
[25] Parashtrimet e *Smakajt*, para. 1.
[26] Parashtrimet e *Smakajt*, para. 1.
[27] Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 212, rreshtat 21-25.
[28] Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 235, rreshtat 10-13.
[29] Parashtrimet e *Kilajt*, para. 7.
[30] Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 235, rreshtat 14-15.
[31] Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 236, rreshtat 24-25, f. 237, rreshti 1.

të përligjen siç duhet me vonesat që rezultojnë nga mospërfundimi i detyrave nga ofrues të jashtëm të shërbimeve të cilët mund të jenë duke ndihmuar hetimin.[32]

5. Mbrojtja e Kuçit

17. Mbrojtja e Kuçit argumenton se të gjitha hapat hetimore dhe nxjerrja pasuese e materialit, si dhe kontestimet juridike të mundshme lidhur me to, duhet të përfundojnë para gjykimit.[33] Ajo komenton se parashikimet e ZPS-së lidhur me përfundimin e mundshëm të detyrave hetimore nga ofruesit e jashtëm të shërbimit mund të jenë shumë optimiste, duke ngritur kështu dyshime lidhur me kohën kur ZPS-ja mund të jetë gati për gjykim.[34]

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

18. Neni 21(4)(d) garanton të drejtën e të akuzuarve "për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme".

19. Neni 40(2) kërkon që Gjykatësi i Vetëm të sigurojë që:

> shqyrtimi gjyqësor të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procedurat të zhvillohen në pajtim me rregullat e procedurës dhe provave, në respekt të plotë të drejtave të akuzuarit dhe duke i kushtuar kujdesin e duhur mbrojtjes së […]dëshmitarëve. Pasi t'i ketë dëgjuar palët, [Gjykatësi i Vetëm] mund të miratojë procedura dhe modalitete që janë të nevojshme për të mundësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurave. [Ai] mund të japë udhëzime për zhvillimin e procedurave të drejta dhe të paanshme dhe në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe të Provave.

20. Rregulla 116(2) i kërkon trupit gjykues të cilit i është caktuar çështja që "shpejt pas caktimit të mbajë një Konferencë Përgatitore për Gjykimin" dhe Konferencën Përgatitore për Prokurorin e Specializuar "brenda tridhjetë (30) ditësh pas mbajtjes

[32] Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 237, rreshtat 10-13.
[33] Parashtrimet e *Kuçit*, para. 2.
[34] Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 233, rreshtat 8-19.

së Konferencës Përgatitore për Gjykimin". Rregulla 118(3) kërkon që "hapja e çështjes […] bëhet tridhjetë (30) ditë pas konferencës përgatitore për Prokurorin e Specializuar".

IV. DISKUTIM

A. FILLIMI I GJYKIMIT

21. Pavarësisht afateve të përcaktuara në rregullat 116(2) dhe 118(3), Gjykatësi i Vetëm ka diskrecion në lidhje me kalendarin e seancave gjyqësore,[35] që mund të ushtrohet në bazë të një game të gjerë faktorësh.[36] Ky diskrecion, në çdo rast, duhet të ushtrohet në përputhje me detyrimin mbizotërues sipas nenit 40(2) për të siguruar një proces të drejtë dhe të shpejtë.[37]

22. Gjykatësi i Vetëm cakton si datë të fillimit të gjykimit **të martën, 24 shkurt 2026, ora 09:30**, e cila do të pasohet nga një bllok i vetëm që do të përfundojë deri **të premten, 6 mars 2026,** gjatë të cilit Prokuroria do të paraqesë provat e saj.

23. Gjykatësi i Vetëm vëren se data e fillimit të gjykimit është brenda ose afër afateve brenda të cilave të gjitha palët treguan se do të ishin të disponueshme dhe të gatshme për gjykim.[38]

---

[35] International Criminal Tribunal for Rwanda, *Prosecutor v. Ngirabatware*, ICTR-99-54-A, Appeals Chamber, *Decision on Augustin Ngirabatware's Appeal of Decisions Denying Motions to Vary Trial Date*, 12 May 2009, public, para. 13.

[36] International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia ("ICTY"), *Prosecutor v. Milosević*, IT-02-54-AR73.6, Appeals Chamber, *Decision on the Interlocutory Appeal by the Amicus Curiae against the Trial Chamber Order Concerning the Presentation and Preparation of the Defence Case*, 20 January 2004, public, para. 16.

[37] *Shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Radovan Karadžić*, IT-95-5/18-AR73.7, Appeals Chamber, *Decision on Appeal from Decision on Motion for Further Postponement of Trial*, 31 March 2010, public, para. 23.

[38] *Shih më lart* para. 11, 14-17. Gjykatësi i Vetëm vëren se Parashtrimet e *Smakajt* i referoheshin shprehimisht periudhave gjatë të cilave të dy mbrojtësit do të ishin të disponueshëm (19 janar deri më 13 shkurt dhe 2 deri më 27 mars 2026) dhe kur asnjëri mbrojtës nuk do të ishte i disponueshëm (nga 27 marsi deri në qershor 2026). Gjykatësi i Vetëm kupton nga këto parashtrime se të paktën një

24. Megjithëse kjo datë është katër ditë pune përpara vlerësimit të Mbrojtjes së Thaçit për gatishmërinë e saj për gjykim,[39] Gjykatësi i Vetëm konsideron se z. Thaçi nuk i shkaktohet asnjë padrejtësi nga fillimi i gjykimit në këtë datë. Ka kaluar kohë e mjaftueshme që nga nxjerrjet përkatëse të materialit (pavarësisht detyrimeve të njëkohshme në Çështjen 06) për t'i lejuar z. Thaçi kohë të mjaftueshme për t'u konsultuar për aspektet përkatëse të Aktakuzës dhe Dosjes Paraprake[40] të ZPS-së në përgjithësi, si dhe për aspekte konkrete që do të trajtohen nga tre dëshmitarët e thirrur nga ZPS-ja. Në fakt, dëshmia e këtyre tre dëshmitarëve është e kufizuar në fushëveprim dhe, në lidhje me Dëshmitarin 8 dhe Dëshmitarin 9, përfshin aspekte teknike dhe ekspertizë të specializuar për të cilat konsultimet me z. Thaçi nuk përbëjnë ndihmë të rëndësishme. Konsultimet e nevojshme për marrjen në pyetje të Dëshmitarit 7 nga pala jothirrëse janë gjithashtu, duke pasur parasysh temën, ndoshta të kufizuara, dhe deklaratat e tij janë nxjerrë shumë kohë më parë.[41] Nëse Mbrojtja e Thaçit zgjedh, sipas rregullës 117(3), ta shtyjë deklaratën e saj hyrëse deri në fillimin e paraqitjes së provave të saj, apo ta bëjë deklaratën e saj hyrëse menjëherë pas asaj të ZPS-së, do të jetë një vendim i zgjedhur prej saj dhe nuk ndikon në drejtësinë e gjykimit, pavarësisht zgjedhjes që ajo do të bëjë.

mbrojtës i Smakajt është i disponueshëm gjatë periudhave të tjera.; *shih gjithashtu* Transkriptin e Konferencës Përgatitore për Gjykim, f. 245, rreshtat 2-8 (ku bashkëmbrojtësi i z. Smakaj deklaron: "angazhimet ekzistuese profesionale sigurisht që mund të ndryshohen. Për momentin, ato janë angazhime profesionale të fiksuara, por është e qartë se si unë ashtu edhe z. Ris do të duhet ta rishikojmë atë, duke pasur parasysh kalendarin që ju z. Gjykatës e konsideroni të përshtatshëm.")

[39] *Parashtrimet e Thaçit*, para. 9.

[40] Gjykatësi i Vetëm vëren se Mbrojtja e Thaçit i është përgjigjur dosjes paraprake të ZPS-së dhe se ka dorëzuar dosjen e saj. *Shih* KSC-BC-2023-12, F00518, Mbrojtja e Thaçit, *Dosja Paraprake e Mbrojtjes së Thaçit*, 20 tetor 2025, konfidenciale; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 23 tetor 2025, F00518/RED.

[41] ERN 118243-118260 (u nxor më 17 dhjetor 2024), ERN 119396-119410 (u nxor më 17 dhjetor 2024), dhe ERN 125819-125844 (u nxor më 17 shkurt 2025).

25. Gjykatësi i Vetëm gjithashtu është i vetëdijshëm për të drejtën e të akuzuarve për proces të shpejtë, edhe pse të gjithë kanë parashtruar se nuk kundërshtojnë fillimin e gjykimit edhe me vonesë deri në fillim të marsit 2026.[42]

B. AFATET PËR PARASHTRIMET

26. Gjykatësi i Vetëm rikujton se ai tashmë ka caktuar afatin për **të mërkurën, 17 dhjetor 2025**, për ZPS-në për të paraqitur çdo mocion për prova të paraqitura jo përmes dëshmitarëve.[43]

27. Gjykatësi i Vetëm gjithashtu cakton afatet e mëposhtme:

(a) çdo përgjigje e ZPS-së ndaj kundërshtimit të përbashkët të Mbrojtjes lidhur me kualifikimet e Dëshmitarit 8[44] do të dorëzohet deri **të hënën, 15 dhjetor 2025, ora 16:00**, dhe çdo kundërpërgjigje do të dorëzohet deri **të hënën, 22 dhjetor 2025, ora 16:00**;

(b) çdo mocion sipas rregullës 117(2) duhet të dorëzohet deri **të mërkurën, 17 dhjetor 2025, ora 16:00**;

(c) çdo mocion i ZPS-së sipas rregullës 154 duhet të dorëzohet deri **të enjten, 18 dhjetor 2025, ora 16:00**; dhe

(d) zgjedhja që kërkohet sipas rregullës 117(3) duhet të bëhet përmes një parashtrimi të protokolluar deri **të hënën, 2 shkurt 2026, në orën 16:00**.

28. Gjykatësi i Vetëm nuk vlerëson, në bazë të parashtrimeve të marra nga palët deri më sot, se nevojiten konferenca të tjera mbi ecurinë e çështjes para fillimit të gjykimit. Për rrjedhojë, Gjykatësi i Vetëm hedh poshtë kërkesën e ZPS-së që i kërkon Gjykatësit të Vetëm Gjykues të rishqyrtojë vendimin e tij për të

[42] Parashtrimet e *Thaçit*, para. 9; Parashtrimet e *Kilajt*, para. 7; Parashtrimet e *Smakajt*, para. 1; Parashtrimet e *Kuçit*, para. 3; Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykim, f. 236, rreshti 24-25, f. 237, rreshti 1.
[43] Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykim, f. 249, rreshtat 5-8.
[44] KSC-BC-2023-12, F00586, Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Smakajt dhe Mbrojtja e Kilajt, *Njoftim i Përbashkët i Mbrojtjes sipas Rregullës 149*, 1 dhjetor 2025, publik.

mbajtur një konferencë të vetme më 28 nëntor 2025, që përfshin si Konferencën Përgatitore për Gjykimin sipas rregullës 117, ashtu edhe Konferencën Përgatitore të Prokurorit të Specializuar sipas rregullës 118.[45] Megjithatë, ZPS-ja mund të bëjë një kërkesë të arsyetuar për një konferencë shtesë mbi ecurinë e çështjes para fillimit të gjykimit nëse lindin rrethana që e kërkojnë këtë. Palët nuk kërkohet të jenë të disponueshme për dy javët që fillojnë më 26 janar 2026, në varësi të planifikimit të mundshëm të një konference të tillë tjetër mbi ecurinë e çështjes.

29. Urdhri për zhvillimin e gjykimit do të lëshohet në kohën e duhur.

V. VENDIM

30. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

a. **URDHËRON** që gjykimi në këtë çështje të fillojë **të martën, 24 shkurt 2026, ora 09:30**;

b. **URDHËRON** palët të respektojnë afatet e përcaktuara në paragrafin 27; dhe

c. **HEDH POSHTË** kërkesën e ZPS-së për rishqyrtim të vendimit për të mbajtur njëkohësisht Konferencën Përgatitore për Gjykimin dhe Konferencën Përgatitore të ZPS-së më 28 nëntor 2025.

___/nënshkrimi/___

Gjykatës Kristofer Gosnell
Gjykatës i Vetëm

[45] Urdhri, para. 10-11; Parashtrimet e ZPS-së, para. 35; Transkripti i Konferencës Përgatitore për Gjykimin, f. 201, rreshtat 1-11, f. 202, rreshti 1.

PUBLIC
Date original: 04/12/2025 17:44:00
Date translation: 17/09/2026 13:50:00

E enjte, 4 dhjetor 2025

Në Hagë, Holandë.